

## **Procesi i vendimmarrjes në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”**

Procesi i vendimmarrjes në USH është një element i rëndësishëm i menaxhimit dhe funksionimit të institucionit. Ai rregullohet kryesisht nga *Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, i cili përcakton strukturat drejtuese, kompetencat dhe mënyrën e organizimit të vendimmarrjes. Ky ligj synon të garantojë autonominë universitare, transparencën dhe pjesëmarrjen në vendime që lidhen me arsimin, kërkimin shkencor dhe administrimin.

### **Organet kolegjiale në USH**

Organet kolegjiale në USH janë struktura që marrin vendime të rëndësishme për funksionimin akademik dhe administrativ të universitetit.

#### **1. Asambleja e Personelit Akademik**

Asambleja e personelit akademik e USH-së përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore dhe ka kompetencën për të zgjedhur rektorin e universitetit. Ndërsa asambleja e personelit akademik e çdo njësie kryesore përfshin personelin akademik me kohë të plotë të asaj njësie dhe ka përgjegjësi të zgjedhë anëtarët e Senatit Akademik, drejtuesin e njësisë kryesore ose dekanin e fakultetit, si dhe të krijojë dhe të zgjedhë anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë. Përveç këtyre, asambleja mund të ushtrojë edhe kompetenca të tjera sipas përcaktimeve në statutin e USH-së.

#### **2. Senati Akademik**

Senati Akademik është organi më i lartë akademik i USH-së dhe një organ kolegjial që mban përgjegjësi për përmbushjen e misionit të universitetit. Ai kryesohet nga rektori dhe mbledhet zakonisht një herë në muaj.

Senati Akademik ka një sërë funksionesh kryesore, si garantimi i autonomisë së universitetit, lirisë akademike dhe të drejtave të studentëve; miratimi i planit strategjik të zhvillimit dhe i planit buxhetor të universitetit; miratimi i ndarjes së burimeve financiare dhe i strukturës së përgjithshme organizative; si dhe miratimi i statutit, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor. Ai gjithashtu vlerëson cilësinë e veprimtarisë akademike dhe kërkimore, miraton raportet vjetore të veprimtarisë dhe financave, planin vjetor të aktiviteteve akademike, si dhe propozon kuotat e pranimeve dhe tarifat e studimit.

Senati vendos për hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të universitetit, miraton kriteret e pranimit në të tri ciklet e studimit, siguron standard e zhvillimit të provimeve dhe miraton rregulloret e brendshme të universitetit.

### **3. Komisionet e përhershme**

Komisionet e përhershme janë struktura që ndihmojnë në funksionimin e organeve drejtuese duke trajtuar çështje specifike, si cilësia në arsim, kërkimi shkencor apo çështjet akademike. Ato përgatisin propozime dhe raporte për organet vendimmarrëse.

### **4. Rektorati**

Rektorati është organi drejtues që ndihmon rektorin në administrimin dhe drejtimin e universitetit. Ai koordinon veprimtarinë e fakulteteve dhe strukturave të tjera akademike.

### **5. Dekanati**

Dekani dhe dekanati drejtojnë fakultetin dhe janë përgjegjës për organizimin e procesit mësimor, menaxhimin e stafit akademik dhe zhvillimin e programeve të studimit në nivel fakulteti.

### **6. Bordi i Administrimit**

Bordi i Administrimit i Universitetit të Shkodrës është organi përgjegjës për administrimin financiar dhe menaxhimin e burimeve të universitetit. Ai miraton buxhetin dhe monitoron përdorimin e fondeve.

### **7. Këshilli i Etikës**

Këshilli i Etikës është organi që mbikëqyr respektimin e parimeve etike në universitet. Ai trajton rastet e shkeljeve etike dhe jep rekomandime për ruajtjen e integritetit akademik.

Informacion me i detajuar në lidhje me funksionet dhe detyrat e organeve kolegjiale të USH-së mund të aksesohet në këtë link:

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2023/Dokumenta\\_User/statutu/Statuti\\_USH\\_qershor\\_2018.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Dokumenta_User/statutu/Statuti_USH_qershor_2018.pdf)

**Vendimmarrja e AP (vendime/rekomandime/urdhrat, etj) mund të aksesohen në këtë link:**

Vendime të Senatit Akademik: <https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/senati-akademik#documents-sen>

Vendime të Bordit të Administrimit: <https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/bordi-administrimit#venbor>